



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Shkurt 2022

Nr: 85

V E N D I M

P Ë R

**SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË QENDRESA QYTETARE PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot, më datë 18.2.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi kërkesën e:

**KËRKUES:** Qëndresa Qytetare me seli në Tiranë, Sheshi “Avni Rustemi” Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Ap. A17, me përfaqësues z. Rigels Xhemollari;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”,

**VËREN:**

Qëndresa Qytetare i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) përfaqësuesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor. Qëndresa Qytetare është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor.



## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

### V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues afatgjatë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 16 (gjashtëmbëdhjetë) përfaqësuesve të Qëndresa Qytetare, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

